



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 634 Prot.

Tiranë, më 28.05 2019

VENDIM Nr. 113, datë 2.05.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48 dhe *VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 2.05.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit *"Rikonstruksion Sanitarizim dhe Adaptim objekti" Lagjja Nr.1, rruga "Koloneli Tomson" zonë arkeologjike "A" Durrës*, subjekti *Z. Ilirian Mano*,

VENDOSI:

1. Të miratojë zhvillimin e projektit *"Rikonstruksion Sanitarizim dhe Adaptim objekti" Lagjja Nr.1, rruga "Koloneli Tomson" zonë arkeologjike "A" Durrës*, subjekti *Z. Ilirian Mano*, me kushtin e ruajtjes së themeleve ekzistuese dhe moscënimit të territorit.
2. Subjekti *Z. Ilirian Mano*, të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, subjekti *Z. Ilirian Mano*, duhet të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik për fillimin e punimeve. Këto punime sipas fazave të zbatimit të projektit do të monitorohen nga DRKK Durrës.
4. Në rast të domosdoshmërisë së kryerjes së punimeve të infrastrukturës inxhinjerie, të paparashikuara për projektin e sipërpërmendur, subjekti *Z. Ilirian Mano* duhet të njoftojë zyrtarisht DRKK Durrës dhe ASHA. Ai duhet të lidhë paraprakisht, akt-marrëveshje tre palëshe me DRKK Durrës, e cila do të monitorojë në mënyrë periodike ditore kryerjen e këtyre punimeve, si dhe ASHA që do të realizojë mbikëqyrjen e tyre.
5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO